

Emri i Lëndës : Shtypi i Shkruar dhe Online

Kodi	Tipi i lëndës	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
COM 252	D	4	3	0	0	3.00	5
Lektori dhe orari i konsultimeve			Valmora Gogo, PhD				
Asistenti dhe orari i konsultimeve							
Gjuha e kursit			Albanian				
Niveli i lëndës			Bachelor				
Përshkrimi			Lënda ofron një përmbajtje të zgjeruar mbi shtypin e shkruar dhe atë online. Në këtë kurs do të trajtohen në mënyrë të detajuar zhanret kryesore të gazetarisë, si dhe sfidat e shtypit tradicional përballë medias online. Cilat janë karakteristikat kryesore të shtypit shqiptar? Cilat janë sfidat e medias tradicionale në erën e zhvillimeve të vrullshme teknologjike? A do t'i mbijetojë shtypi medias online? Shtypi i shkruar përballë medias online do të jetë në fokus të këtij kursi.				
Objektivat			Në këtë kurs synohet që studentët: - Të kuptojnë dhe njohin të gjitha zhanret e gazetarisë tradicionale. - Të njohin dhe zhvillojnë njohuritë e tyre mbi zhvillimet e vazhdueshme të medias online. - Të aftësohen mbi mënyrat e përcjelljes së informacionit nëpërmjet shtypit të shkruar dhe medias online. - Të konceptojnë më qartë sfidën midis medias tradicionale dhe asaj të re.				

Programi i Lëndës

Java	Tema
1	Si ka ndryshuar peizazhi mediatik dhe sfidat e reja. Trajtimi i konvergjencës, digjitalizimit, ndryshimit mes lexuesve dhe audiencave interaktive, hibridizimi etj. Pse redaksive të shtypit u është dashur të përshtaten me zhvillimet e teknologjisë dhe internetit? Pse u desh të kalonin në versione online, madje të krijonin nën mbrojtjen e tyre media të mirëfillta online?
2	Parimet e raportimit dhe shkrimit të lajmeve. A kanë ndryshuar? Si menaxhohen lajmet në modele të reja të redaksive. Si kanë ndryshuar redaksitë tradicionale të lajmeve.
3	Profili i ri i gazetarit; çfarë mban të trashëguar nga modeli tradicional i të bërit gazetari në shtyp dhe çfarë aftësish të reja ka fituar. Burimet. Të bësh gazetari në 2020-ën.
4	Pika lidhëse mes shtypit të botuar dhe atij online: ZHANRET. Çfarë janë zhanret dhe si kanë ndryshuar ato? Një thellim mbi gazetarinë e re dhe atë tradicionale me fokusin te zhanret: zhanret informative, analitike, zhanret në medien online etj.
5	Pse ka rëndësi të kuptojmë që sot kushdo mund të prodhojë përmbajtje mediatike; Edukimi Mediatik dhe njohja me rreziqet në një hapësirë të mbingarkuar me informacion.
6	Komunikimi vizual dhe multimedia- e reja që sjell peizazhi i ri mediatik. Nga faqosësit te mjeshtëria e gazetarëve në përdorimin e audios, videos, fotove, grafikëve etj.
7	Njohja dhe shërbimi etik ndaj audiencës interaktive. Ndjekja e lajmit. Kush po na lexon?
8	Provim Gjysmëfinal
9	Ku ta gjejmë frymëzimin? Si të zgjedhim temën për artikullin e radhës. Si të punojmë me burimet, balancën etj. Një investigim mund të gjejë dritën e publikimit i nxitur edhe nga statuse audiencash në "Facebook" e rrjete të tjera sociale. Si të përdorim rrjetet sociale në mënyrë të zgjuar.
10	Si të shkruajmë për një medie online? Parimet e një shkrimi të mirë. Shpejtësia dhe saktësia.
11	Si të shkruajmë për një medie online? Mjetet dhe teknikat. Të zbatuarit e shumë detyrave njëherësh.
12	Si të redaktojmë për një medie online? Parimet e punës me rezultat.
13	Si të redaktojmë për një medie online? Zëri dhe stili. Të shkruash shqip.
14	Vendosja dhe komunikimi i besueshmërisë në hapësirat digjitale. E drejta e autorit.
15	Prezantim Projekti

16	Provim Final		
	Parakushtet		
	Literatura	<ul style="list-style-type: none"> • "The Handbook of Global Online Journalism", Edited by Eugenia Siapera and Andreas Veglis, John Wiley & Sons, Inc, 2012 • "Writing and Editing for Digital Media", Brian Carroll, Routledge, 2017 3. • "Zhanret e Gazetarisë", Bajram Kosumi, UBT, 2016 • "Zhanret e Gazetarisë", Bajram Kosumi, UBT, 2016 • "Editoriali në shtypin shqiptar të tranzicionit", Valmora Gogo, Universiteti i Tiranës, disertacion, 2017 	
	Referenca të tjera	<ul style="list-style-type: none"> • "The Language of Journalism: A Multi-genre Perspective", Michael Higgins, Angela Smith, Bloomsbury Academic, 2013 • "Emerging Genres in New Media Environments", Carolyn R. Miller, Ashley R. Kelly (eds.), Palgrave Macmillan, 2017 • "Blur: How to Know What's True in the Age of Information Overload", Bill Kovach, Tom Rosenstiel, Bloomsbury USA, 2010 • "White Space Is Not Your Enemy: A Beginner's Guide to Communicating Visually Through Graphic, Web and Multimedia Design", Golombisky, K., Hagen, R. (3rd ed.). Boca Raton: Taylor & Francis, 2016 	
	Punë laborator		
	Përdorimi i komp.		
	Të tjera		
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat			
1	Studentët do të pajisen me njohuri mbi shtypin dhe median online.		
2	Studentët do të jenë të aftë të dallojnë dhe përgatisin lajme për t'i publikuar në gazeta, revista dhe faqe interneti.		
3	Studentët do të jenë në gjendje të diskutojnë e të mbrojnë mendimet dhe idetë e tyre mbi median shqiptare në përgjithësi, si kontribut për ndërtimin e një shoqërie të lirë dhe të integruar.		
Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
	Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
	Gjysmë finale	1	40
	Kuize	0	0
	Projekte	0	0
	Projekte semestrale	0	0
	Punë laborator	0	0
	Pjesëmarrja në mësim	1	10
	Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		50
	Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		50
	Total		100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
	Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)
	Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	48
	Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	56
	Detyra	0	0
	Gjysmë finale	1	8

Provimi final	1	13	13
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			125
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5
ECTS			5